



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni Pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-029
Prishtinë, më 19 prill 2018, në orën 16:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 19 PRILL 2018

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Kujtim Shala Aida Dërguti dhe Mufera Shinik, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Avdullah Hoti, Memli Krasniqi, Albulena Haxhiu, Dardan Sejdiu, Ahmet Isufi, Bilall Sherifi dhe Albert Kinolli.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Avni Bytyqi dhe Valmir Klaiqi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga EUSR-ja: Blerta Bejtullahu,

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati.

Mbledhjen e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi i kërkesës për seancë të jashtëzakonshme,
2. Vazhdimi i seancës plenare me pikat e papërfunduara,
3. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
4. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

1. Shqyrtimi i kërkesës për seancë të jashtëzakonshme

Kryetari i njoftoi të pranishmit me kërkesën e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, të nënshkruar nga 40 deputetë, për seancë të jashtëzakonshme të Kuvendit, më 20 prill 2018, për debat parlamentar lidhur me Raportin e Progresit për Republikën e Kosovës.

Kryetari i njoftoi të pranishmit se raporti për vendin, mbi bazën e të cilit është kërkuar debati parlamentar, është vetëm në gjuhën angleze dhe se akoma nuk është përkthyer në gjuhët zyrtare.

Kërkesën për seancë të jashtëzakonshme, në emër të GP të LVV-së dhe deputetëve nënshkrues, e arsyetoi deputetja Albulena Haxhiu, diskutimi i së cilës është i dhënë në transkript.

Lidhur me kërkesën për seancë të jashtëzakonshme diskutuan: Kujtim Shala, nënkryetar i Kuvendit; Avdullah Hoti, në emër të GP të LDK-së; Bilall Sherifi, në emër të GP Nisma Socialdemokrate; Ahmet Isufi, në emër të GP të AAK-së; Dardan Sejdiu, në emër të GP Deputetët e Pavarur; Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së dhe Albulena Haxhiu në emër të GP të LVV-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, me pëlqimin e përfaqësuesve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit të mbahet të premten, më 20 prill 2018, në orën 12:00, me këtë:

Rend dite

- 1. Debat parlamentar lidhur me Raportin e Progresit për Republikën e Kosovës*

2. Vazhdimi i seancës plenare me pikat e papërfunduara

Kryetari i njoftoi të pranishmit me kërkesën e kryeministrit, z. Ramush Haradinaj, që vazhdimi i seancës plenare me pikat e rendit të ditës, - interpelancat për kryeministrin të mbahet më 26 prill 2018, pas orës 12:00.

Kryesia, me pëlqimin e përfaqësueseve të grupeve parlamentare, vendosi që vazhdimi i seancës plenare të Kuvendit me pikat e papërfunduara të mbahet të enjten, më 26 prill 2018, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

- 1. Votimi i Projektligjit nr. 06/L-061 për ratifikimin e Traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë për transferimin e personave të dënuar,*
- 2. Votimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e gjashtë (6) anëtarëve të Bordit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit,*
- 3. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e dy (2) anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Medieve,*
- 4. Votimi i mocionit nga interpelanca në lidhje me Sistemin Informativ Shëndetësor dhe sigurimet shëndetësore publike dhe private në Republikën e Kosovës,*
- 5. Votimi i rekomandimeve nga debati parlamentar në lidhje me skandalin e mishit të prishur të ardhur nga Belgjika, si dhe cilësinë dhe sigurinë e ushqimit në Kosovë,*
- 6. Votimi i rekomandimeve nga debati parlamentar në lidhje me korrupsionin si kriter për liberalizim të vizave,*
- 7. Votimi i rekomandimeve nga debati parlamentar në lidhje me sigurinë e fëmijëve në përdorimin e internetit në Kosovë,*
- 8. Formimi i Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me ndriçimin e rastit të dëbimit të gjashtë (6) shtetasve turq.*
- 9. Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, në lidhje me reduktimet e ashpra të furnizimit me energji elektrike dhe situatën në sektorin e energjisë,*
- 10. Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, në lidhje me vendimin e Qeverisë së Kosovës nr. 02/34, datë 5. 3. 2018, për ndarjen e mjeteve financiare në shumën prej një milion euro për KOSTT-in për mbulimin e shpenzimeve të furnizimit me energji elektrike të katër komunave në veri të Kosovës,*
- 11. Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupi Parlamentar Deputetët e Pavarur, në lidhje me nënshkrimin e marrëveshjes komerciale ndërmjet kompanisë “Contour Global” dhe Qeverisë së*

Kosovës për projektin e Termocentralit “Kosova e Re”, të nënshkruar më 20 dhjetor 2017,

12. Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, në lidhje me korrupsionin dhe krimin e organizuar në institucionet dhe zyrtarët e lartë të Republikës së Kosovës.

3. Përgatitjet për seancë plenare të radhës

Kryetari i njoftoi të pranishmit me pikat e rendit të ditës që i plotësojnë kushtet për shqyrtim në seancë plenare të radhës.

Lidhur me propozimin e rendin e ditës për seancën plenare të radhës diskutuan: Avdullah Hoti, në emër të GP të LDK-së dhe Albulena Haxhiu, në emër të GP të LVV-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Në vazhdim, kryetari i Grupit Parlamentar Deputetët e Pavarur, z. Dardan Sejdiu, i propozoi Kryesisë së Kuvendit që ndarja e pozitive për GP Deputetët e Pavarur në komisionet parlamentare të radhiten pikë e rendit të ditës të kësaj seance.

Në lidhje me propozimin e lartcekur të z. Sejdiu, diskutuan kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli dhe Albulena Haxhiu në emër të GP të LVV-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, propozimin e kryetarit të GP Deputetët e Pavarur e shtyu përmbledhjen e radhës.

Pas diskutimeve, Kryesia e Kuvendit, me pëlqimin e përfaqësuesve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare e radhës të mbahet të enjten, më 3 maj 2018, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

- 1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
- 2. Koha për pyetje parlamentare,*
- 3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,*
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë për ekstradim,*
- 5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve,*
- 6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për amnistinë,*
- 7. Emërimi i drejtorit dhe zëvendësdrejtorit të Sekretariatit Ekzekutiv të Agjencisë për Krahasim dhe Verifikim të Pronës,*

8. *Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për (1) një anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga komuniteti shqiptar,*

9. *Propozimi i Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje për shkarkimin e nënkryetares së Kuvendit, znj. Aida Dërguti,*

10. *Formimi i Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me shpenzimet për lobim nga Presidenca dhe Qeveria e Republikës së Kosovës.*

* * *

Gjithashtu, Kryesia lidhur me pikat 8 dhe 10 të lartcekura të rendit të ditës, nxori këto përfundime:

I. Përfundim

1. Kërkohej nga grupet parlamentare të Kuvendit që para seancës së radhës, më 3 maj 2018, t'i propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetarë të parë dhe të dytë, si dhe për anëtarë të Komisionit ad hoc, për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, nga radhët e komunitetit shqiptar.

2. Përbërja e Komisionit ad hoc do të jetë si në vijim: GP i Listës serbe (kryetarin); GP i PDK-së (zëvendëskryetarin e parë dhe 1 anëtar); GP i LVV-së, (Zëvendëskryetarin e dytë dhe 1 anëtar); GP i LDK-së (2 anëtarë); GP Deputetët e Pavarur (1 anëtar); GP i AAK-së (1 anëtar); GP i Nismës Socialdemokrate, (1 anëtar) dhe GP "6+" (1 anëtar).

II. Përfundim

1. Kërkohej nga grupet parlamentare që para seancës së radhës të Kuvendit, më 3 maj 2018, t'i propozojnë deputetët për anëtarë të Komisionit Hetimor Parlamentar, sipas propozimit të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, mbështetur edhe nga deputetët nënshkrues të grupeve të tjera parlamentare për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar, në lidhje me shpenzimet për lobim nga Presidenca dhe Qeveria të Republikës së Kosovës.

2. Përbërja e komisionit do të jetë me 15 anëtarë nga grupet parlamentare: LDK, LVV dhe Deputetët e Pavarur i propozojnë shtatë (7) anëtarë, në mesin e tyre e propozojnë kryesuesin dhe zëvendëskryesuesin, si dhe grupet parlamentare: PDK, AAK, Lista serbe, Nisma Socialdemokrate dhe "6+" i propozojnë tetë (8) anëtarë.

4. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave

1. *Shqyrtimi i propozimi të GP të Lidhjes Demokratike të Kosovës, mbështetur edhe nga deputetët nënshkrues të grupeve të tjera parlamentare për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me shpenzimet për lobim nga Presidenca dhe Qeveria e Republikës së Kosovës*

Kryesia propozimin e lartshënuar e radhiti në rend të ditës për seancën plenare, më 3 maj 2018.

2. Shqyrtimi i kërkesës së kryetares së Komisionit për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, Vjosa Osmani-Sadriu, për lejimin e udhëtimit zyrtar në Beograd

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetes së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani-Sadriu, i lejohej udhëtimit zyrtar në Beograd (Serbi), prej 10-12 maj 2018.

2. Shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe mëditjet për të lartshënuarën në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

3. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike për lejimin e udhëtimit zyrtar në Norvegji

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani-Sadriu, Time Kadrijaj, Danush Ademi, Aida Dërguti, Visar Ymeri, Dukagjin Gorani, Doruntinë Maloku-Kastrati, Elmi Reçica, Evgjëni Thaçi-Dragusha, Sërgjan Mitroviq dhe Zafir Berisha u lejohej udhëtimit zyrtar në Norvegji, prej 7-10 maj 2018.

2. Shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe mëditjet për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

4. Shqyrtimi i kërkesës së deputetit Armend Zemaj për lejimin e udhëtimit zyrtar në Tiranë (Shqipëri)

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Armend Zemaj, i lejohej udhëtimit zyrtar në Tiranë, Shqipëri, prej 25-27 maj 2018.

2. Shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe mëditjet për të lartshënuarin në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

5. *Shqyrtimi i kërkesës së OJQ “Planina” për mbështetje financiare lidhur me organizimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive për ditët e goranëve*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

OJQ Planina nga Dragashi mbështetet financiarisht në shumën prej 4995 Euro për organizimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive për shënimin e ditëve të goranëve, prej datës 6 deri më 10 maj 2018.

6. *Raporti i Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Kroaci, prej 25-27 mars 2018*

Kryesia u njoftua me shkrim nga Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Kroaci, prej 25-27 mars 2018.

7. *Shqyrtimi i kërkesës së OJQ-së “Debat Center” për financim të projektit “Turneu kombëtar i debatit për shkolla të mesme, Kosova Open 2018”*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

OJQ “Debat Center” mbështetet financiarisht në shumën prej 4 999 euro për financimin të projektit “Turneu kombëtar i debatit për shkolla të mesme - Kosova Open 2018”, i cili do të realizohet prej 1 maj deri më 1 korrik 2018.

8. *Shqyrtimi i kërkesës së Shoqatës “Shpresa dhe Kujtimi” në emër të Këshillit Koordinues të Asociacionit të Familjarëve të të Zhdukurve për mbështetje financiare*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

OJQ “Shpresa dhe Kujtimi” mbështetet financiarisht në shumën prej 1 600 euro për organizimin e aktiviteteve për shënimin e “Javës për Personat e Pagjetur”, të cilat do të organizohen prej 23-27 prill 2018.

* * *

Në vazhdim, Kryesia i shqyrtoi edhe këto pika shtesë:

1. Propozimi i kryetarit të Kuvendit për vazhdimin e kontratës së punës të Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit, z. Ismet Krasniqi

Kryesia pasi e vlerësoi performasën e Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit, z. Ismet Krasniqi, dhe punën e përgjithshme të Administratës së Kuvendit, me propozim të kryetarit të Kuvendit, mori këtë:

V E N D I M

Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Ismet Krasniqi, i vazhdohet kontrata e punës deri më 31 korrik 2021.

2. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Integritet Evropian për lejimin e udhëtimit zyrtar në Luksemburg

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Blerta Deliu-Kodra, Armend Zemaj, Fatmire Kollçaku dhe Ahmet Isufi, u lejohet udhëtimi zyrtar në Luksemburg, prej 1-4 maj 2018.

2. Shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe mëditjet për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

3. Shqyrtimi i kërkesës së deputetes Mimoza Kusari-Lila për lejimin e udhëtimit zyrtar në SHBA

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetes së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Mimoza Kusari-Lila, i lejohet udhëtimi zyrtar Uashington D.C, SHBA, prej 22-28 prill 2018.

2. Shpenzimet e udhëtimit dhe të akomodimit prej 22-24 prill 2018 dhe mëditjet për të lartshënuarën në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës, ndërsa shpenzimet e udhëtimit brenda SHBA-ve (Uashington -

Morningtown), shpenzimet e akomodimit dhe ushqimit për 25-27 prill 2018 mbulohen nga organizatori.

4. Shqyrtimi i kërkesës së delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës në udhëtimin zyrtar në Lubjanë (Slloveni), për kompensimin e shpenzimeve të tejkaluara

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet kërkesa nr. 06/1129/Do-627, datë 19. 4. 2018 për kompensimin e shpenzimeve të tejkaluara të anëtarëve të delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës gjatë qëndrimit zyrtar në Lubjanë (Slloveni), prej 12-15 prill 2018, në shumën prej 1 225,00 (njëmijedyqind e njëzet e pesë) euro, sipas faturave të bashkangjitura.

* * *

Në fund, kryetari i Kuvendit propozoi që nënkryetarët e Kuvendit dhe kryetarët grupeve parlamentare të zhvillojnë një aktivitet ndërparlamentar me parlamentet e shteteve anëtare të Unionit Evropian për të lobuar lidhur me liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 17:55 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale